

VENDIM
Nr.225, datë 2.3.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË TRI AUTOKOLONAVE USHTARAKE
ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - porti i Durrësit, në datën 2 mars 2009, të një (1) autokolone ushtarake italiane, të përbëra nga 5 (pesë) automjete dhe 10 (dhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 4 mars 2009, të një (1) autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) trupa.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 6 mars 2009, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 3 (tri) automjete dhe 6 (gjashtë) trupa.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, për autokolonën e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat e përmendura në pikat 2 e 3 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

6. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

7. Autokolonat italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

8. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha